

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR SHKENCËN DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë” propozohet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, e cila i kushton vëmendje të veçantë zhvillimit të shkencës dhe aktiviteteve të tjera të ngjashme ose plotësuese të saj në Republikën e Shqipërisë, organizimit dhe funksionimit të veprimtarive shkencore.

Projektligji synon arritjen e objektivave, si sigurimi i produkteve të kërkimit shkencor, që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, mbrojtjen e mjedisit e të shëndetit publik, si dhe konsolidimin e identitetit dhe mbrojtjen e interesave kombëtarë; përvetësimin e aftësive dhe të njohurive të reja, transferimin e tyre për përfitimin e përgjithshëm publik, me synim rritjen e nivelit të mirëqenies sociale, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit; fuqizimin e aftësive për të menaxhuar e zbatuar progresin teknologjik dhe të përgjithshëm shoqëror, si burimi kryesor i zhvillimit të qëndrueshëm, duke rritur vlerën e punës dhe konkurrueshmërinë; fuqizimin e lidhjeve ndërkombëtare të komunitetit të studiuesve e të kërkuesve shkencorë shqiptarë me ata të zonës evropiane të kërkimit, si dhe me kërkuesit e diasporës, duke promovuar lëvizshmërinë dhe përfshirjen në proceset e integritimit evropian dhe në rrjetet ndërkombëtare të vlerave; ngritjen e kapaciteteve të personelit shkencor dhe nxitjen e zhvillimit të karrierës shkencore, duke siguruar mundësi të barabarta; fuqizimin dhe rritjen e përdorimit të infrastrukturës kërkimore-shkencore duke garantuar akses për të gjithë; zgjerimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e kërkimit shkencor, për të zhvilluar e shfrytëzuar potencialet kërkimore-shkencore; nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të kërkimit shkencor dhe biznesit, institucioneve publike, shoqërisë civile, si dhe palëve të tjera të interesuara në veprimtari kërkimore-shkencore dhe inovacion; promovimin, zgjerimin e rolit të shkencës dhe krijimin e një mjedisi favorizues e mbështetës për kërkimin shkencor në shoqëri.

Ministria e Arsimit dhe Sportit (në vijim, MAS) mbështet prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit, nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar në fusha të ndryshme të shkencës, në kuadër të zhvillimit ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar e rajonal.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është në përputhje të plotë me programin politik të Këshillit të Ministrave, të miratuar me vendimin e Kuvendit nr.68/2021, “Për miratimin e përbërjes dhe programit politik të Këshillit të Ministrave”, i cili synon, ndër të tjera, zhvillimin e shkencës dhe të aktiviteteve të tjera të ngjashme ose plotësuese të saj, në të gjitha fushat e jetës në Republikën e Shqipërisë, të zhvillimit të teknologjisë dhe inovacionit.

Hartimi dhe miratimi i këtij projektligji është në përputhje me përcaktimet e parashikuara në SKZHIE-në e miratuar me vendimin nr.88, datë 22.2.2023, të Këshillit të Ministrave, ku në ndarjen “Zgjerimi i kërkimit shkencor dhe inovacionit” (faqe 114-115) përcaktohet, ndër të tjera, se:

“Shkenca, teknologjia dhe inovacioni në Shqipëri vlerësohen si themelore për një shoqëri të bazuar në dije në të gjitha fazat e zhvillimit ekonomik. Sistemi i kërkimit shkencor përfshin institucionet e arsimit të lartë, institucionet e kërkimit shkencor, zhvillimin e njohurive dhe të teknologjisë (inovacionin), si dhe ndërmarrjet private që operojnë në fushën e kërkimit, zhvillimit dhe inovacionit. Një ndikim të konsiderueshëm në produktet shkencore ka ushtruar përputhja e veprimtarisë kërkimore me direktivat e Bashkimit Evropian dhe iniciativat evropiane, veçanërisht programet “Horizon 2020” dhe aktualisht “Horizon Evropa”.

Si pjesë e agjendës së Ballkanit Perëndimor për inovacionin, kërkimin, edukimin, kulturën, rininë dhe sportet, asociacioni dhe veçanërisht integrimi i Shqipërisë në zonën e re evropiane për kërkim dhe inovacion (ERA) dhe zonën evropiane të arsimit (EEA) do të shërbejë si nxitës për reformat kombëtare dhe tranzicionin e politikave drejt një sistemi kërkimi dhe inovacioni më efikas, duke ndihmuar vendin të rrisë kapacitetet e tij dhe potencialin në infrastrukturë, si dhe përafrimin e tij të vazhdueshëm me *acquis* të Bashkimit Evropian.

Projektligji është pjesë e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për t’u miratuar në vitin 2024, në zbatim të vendimit nr.790, datë 28.12.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2024”.

Në vendimin nr.16, datë 11.1.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024 – 2026”, parashikohet detyrimi i

Republikës së Shqipërisë për të ndërmarrë iniciativa politike, ligjore, institucionale dhe financiare në kapitullin 25, në mbështetje të konsolidimit të sistemit të kërkimit shkencor, i cili rrjedh nga neni 109 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), ku përcaktohen shtyllat e bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian në fushën e kërkimit shkencor e zhvillimit teknologjik (titulli VIII - Politikat e bashkëpunimit/Bashkëpunimi për kërkimin dhe zhvillimin teknologjik).

Projektligji është publikuar për konsultim publik në regjistrin elektronik të njoftimeve dhe konsultimeve publike nga data 4.7.2023 deri më 1.8.2023 dhe është hartuar tabela për përpunimin e të dhënave në funksion të hartimit të raportit për njoftimin dhe konsultimin publik, sipas formatit në shtojcën 1, bashkëlidhur vendimit nr.584, datë 28.8.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, i ndryshuar.

Projektligji, për shkak të ndryshimeve të pësuar, është ripublikuar për konsultim publik në regjistrin elektronik të njoftimeve dhe konsultimeve publike nga data 26.3.2024 deri më 25.4.2024, nga ku nuk ka pasur sugjerime.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ligji nr.7893, datë 22.12.1994, “Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik”, rezulton të jetë një akt shumë i hershëm, i cili nuk gjen më zbatim në shumë komponentë, si dhe nuk rezulton të jetë më koherent me situatën aktuale të kërkimit shkencor në vend. Situata në vend kërkon ndryshime në ligjin ekzistues, e cila do të ishte e pamundur për t’u arritur, pasi do të prekej numri më i madh i dispozitave të ligjit. Teknika legjislative nuk lejon ndryshime thelbësore dhe ekzistojnë kufizime që përcaktojnë një përqindje të dhënë të dispozitave që mund të ndryshohen me ligj. Ministria e Arsimit dhe Sportit, si institucioni përgjegjës për shkencën në Republikën e Shqipërisë, kishte detyrimin që të adresonte një zgjidhje për moszbatueshmërinë e këtij akti në fuqi.

Në këto kushte, u ngrit grupi i punës në zbatim të urdhrit nr.57, datë 25.3.2022, të Kryeministrit, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit “Për shkencën në Republikën e Shqipërisë””. Pas analizës së gjendjes dhe të studimit të disa modeleve të ligjeve të fushës së kërkimit shkencor, grupi i punës arriti të formësojë një projektligj, i cili do të arrijë të rregullojë një sërë hendeqesh dhe problematikash të shfaqura deri më tani, të cilat nuk gjenin një zgjidhje përfundimtare në aktin në fuqi.

Në projektligj përcaktohet objekti i ligjit, i cili është përcaktimi i rregullave dhe i procedurave për organizimin dhe funksionimin e sistemit të shkencës dhe

kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, në projektligj përcaktohet qëllimi i ligjit për të krijuar kushte për zhvillimin dhe funksionimin e një sistemi bashkëkohor të shkencës, si dhe garantimin e mundësimin e financimit të këtij sistemi nga burime të ligjshme.

Nëpërmjet këtij projektligji vendoset korniza e përgjithshme ligjore për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të kërkimit shkencor, të personelit kërkimor-shkencor, që ushtron veprimtarinë në këto institucione, dhe përcaktohet modeli i financimit të institucioneve të kërkimit shkencor, në varësi të formës së organizimit të tyre.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji propozohet në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Në aspektin e integritimit në Bashkimin Evropian, projektligji është në koherencë të plotë me parimet e përcaktuara në dispozitat e Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE), kapitulli XIX, mbi kërkimin. Gjithashtu, projektligji ka për qëllim plotësimin e detyrimeve, që burojnë nga procesi i asociimit të Bashkimit Evropian lidhur me kapitullin 25, “Shkenca dhe kërkimi shkencor”. Projektligji është parashikuar në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian të miratuar me vendimin nr.16, datë 11.1.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024 – 2026”.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji “Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë” përmban tetë krerë dhe është i strukturuar në 41 nene.

Kreu I përmban dispozitat e përgjithshme dhe është i përbërë nga 6 nene.

Neni 1 parashikon objektin e projektligjit, i cili është përcaktimi i rregullave dhe i procedurave për organizimin dhe funksionimin e sistemit të shkencës dhe kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë. Ky ligj është i zbatueshëm për çdo institucion apo entitet, që është pjesë e sistemit të shkencës dhe kërkimit shkencor.

Neni 2 përcakton qëllimin dhe objektivat e projektligjit. Qëllimi është të krijojë kushte për zhvillimin dhe funksionimin e një sistemi bashkëkohor të shkencës dhe kërkimit shkencor e të rregullojë dhe të garantojë mundësimin e financimit të këtij sistemi nga burime të ndryshme financimi, sipas përcaktimeve në këtë ligj.

Ligji synon arritjen e objektivave, si më poshtë:

- Sigurimin e produkteve të kërkimit shkencor, që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit publik, si dhe konsolidimin e identitetit dhe mbrojtjen e interesave kombëtarë;
- Përvetësimin e aftësive dhe njohurive të reja, transferimin e tyre për përfitimin e përgjithshëm publik, me synim rritjen e nivelit të mirëqenies sociale, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit;
- Fuqizimin e aftësive për të menaxhuar dhe zbatuar progresin teknologjik e të përgjithshëm shoqëror, si burimi kryesor i zhvillimit të qëndrueshëm, duke rritur vlerën e punës dhe konkurrueshmërinë;
- Fuqizimin e lidhjeve ndërkombëtare të komunitetit të studiuesve dhe të kërkuesve shkencorë shqiptarë me ata të zonës evropiane të kërkimit, si dhe me kërkuesit e diasporës, duke promovuar lëvizshmërinë dhe përfshirjen në proceset e integritetit evropian;
- Ngritjen e kapaciteteve të personelit shkencor dhe nxitjen e zhvillimit të karrierës shkencore, duke siguruar mundësi të barabarta;
- Fuqizimin dhe rritjen e përdorimit të infrastrukturës kërkimore-shkencore, duke garantuar akses për të gjithë;
- Zgjerimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e kërkimit shkencor, me qëllim zhvillimin dhe shfrytëzimin e potencialeve kërkimore-shkencore;
- Nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të kërkimit shkencor dhe biznesit, institucioneve publike, shoqërisë civile, si dhe palëve të tjera të interesuara në veprimtari kërkimore-shkencore dhe inovacion;
- Promovimin, zgjerimin e rolit të shkencës dhe krijimin e një mjedisi favorizues e mbështetës për kërkimin shkencor në shoqëri.

Neni 3 përmban përkufizimin e termave të tekstit të projektligjit.

Neni 4 përcakton parimet mbi të cilat bazohet sistemi i shkencës dhe i kërkimit shkencor, si liria e kërkimit shkencor, ofrimi i mundësive të barabarta, mosdiskriminimi, barazia gjinore, transparencë, shkenca e hapur, konkurrenca në shkencë, cilësia në shkencë, efikasiteti në shkencë, etika në shkencë, përgjegjshmëria në shkencë, bashkëpunimi dhe koordinimi ndërinstitucional dhe financimi eficient.

Neni 5 i referohet parimit të shkencës së hapur, ku parashikohet se institucionet që zhvillojnë kërkim shkencor, të financuara apo të bashkëfinancuara me mjete financiare publike, zbatojnë parimin e shkencës së hapur.

Të dhënat dhe produktet e kërkimit shkencor, të financuara e të bashkëfinancuara me fonde publike, janë të hapura, të aksesueshme, ndërvepruese dhe të ripërdorshme, duke iu nënshtuar vetëm kufizimeve të vendosura nga mbrojtja e të drejtave të pronësisë intelektuale, mbrojtja e të dhënave personale, si dhe siguria e individëve ose e shtetit.

Kërkuesit shkencorë ose çdo përfitues i financimit publik të kërkimit shkencor i bën publikimet e tij të disponueshme dhe të aksesueshme për publikun.

Parimi i shkencës së hapur dhe praktikat që e stimulojnë atë janë kritere të vlerësimit të institucioneve, projekteve kërkimore dhe karrierës së kërkuesit shkencor.

Infrastruktura e kërkimit shkencor të jetë e hapur duke bërë të mundur që kërkuesit shkencorë të ndajnë dhe të përpunojnë rezultatet e të dhënave të kërkimit, të financuara ose bashkëfinancuara me fonde publike, përtej kufijve kombëtarë dhe pavarësisht fushës së kërkimit shkencor.

Standardet dhe kriteret që mundësojnë zbatimin e parimit të shkencës së hapur dhe janë në përputhje me politikat e zonës evropiane të kërkimit, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6 parashikon klasifikimin e fushave dhe nënfushave të kërkimit shkencor, të cilat miratohen me urdhër të ministrit, bazuar në Sistemin Evropian të Kërkimit Shkencor dhe atë ndërkombëtar.

Kreu II përcakton, nga nenet 7 deri 11, organizimin e sistemit të shkencës e të kërkimit shkencor.

Neni 7 parashikon sistemin e shkencës dhe të kërkimit shkencor, i cili përfshin institucionet politikëbërëse, zhvilluese, financuese dhe vlerësuese të veprimtarisë së kërkimit shkencor. Institucionet politikëbërëse janë Ministria dhe Këshilli Kombëtar për Shkencën dhe Kërkimin Shkencor. Institucionet zhvilluese janë Akademia e Shkencave, institucionet e arsimit të lartë dhe çdo institucion apo entitet, publik apo jopublik, i cili krijohet dhe vepron sipas dispozitave të këtij ligji. Institucionet financuese janë Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe çdo institucion apo organizatë tjetër publike ose jopublike, që

financon sistemin e shkencës dhe kërkimin shkencor. Institucionet vlerësuese të veprimtarisë së kërkimit shkencor janë Ministria dhe Akademia e Shkencave.

Neni 8 parashikon rolin e ministrisë. Ministria është institucioni përgjegjës që harton, drejton, koordinon dhe realizon politikat e programit qeverisës në fushën e shkencës dhe të kërkimit shkencor. Ministria vlerëson veprimtarinë kërkimore të institucioneve të kërkimit shkencor, financuar me fonde publike, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe administron Regjistrin Kombëtar të Institucioneve, Instituteve, Njësive të Veçanta të Kërkimit Shkencor dhe Kërkuesve Shkencorë, në përputhje me këtë ligj.

Ministri ka këto kompetenca:

- a) Harton politika në fushën e shkencës dhe kërkimit shkencor, si dhe i propozon Këshillit të Ministrave miratimin e strategjisë në këtë fushë;
- b) Harton dhe propozon në Këshillin e Ministrave fushat dhe nënfushat prioritare të kërkimit shkencor;
- c) Propozon në Këshillin e Ministrave modelin e financimit të buxhetit për shkencën dhe kërkimin shkencor, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe akteve të tjera, ligjore e nënligjore në fuqi;
- ç) Harton dhe propozon për miratim pranë Këshillit të Ministrave Kodin e Etikës në Shkencë dhe në Kërkim Shkencor të harmonizuar me Kodin Evropian të Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor.

Neni 9 parashikon ngritjen e Këshillit Kombëtar për Shkencën dhe Kërkimin Shkencor, i cili është një organ kolegjal këshillimor i ngritur pranë Kryeministrit, që ka për detyrë të përmirësojë veprimtarinë kërkimore-shkencore në vend, duke dhënë rekomandime lidhur me të.

Neni 10 parashikon përbërjen e Këshilli Kombëtar për Shkencën dhe Kërkimin Shkencor, që drejtohet nga Kryeministri dhe përbëhet nga 19 anëtarë, si më poshtë:

- Ministri përgjegjës për shkencën;
- Ministri përgjegjës për inovacionin;
- Ministri përgjegjës për energjinë;
- Ministri përgjegjës për bujqësinë;
- Ministri përgjegjës për shëndetësinë;
- Ministri përgjegjës për mbrojtjen;
- Ministri përgjegjës për mjedisin;
- Katër përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë;
- Kryetari dhe tre përfaqësues të Akademisë së Shkencave;
- Dy përfaqësuesit e qendrave të transferimit të teknologjive bujqësore;

- Përfaqësuesi i Agjencisë së Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit;
- Përfaqësuesi i Agjencisë së Inovacionit dhe Ekselencës.

Anëtarët e këtij këshilli, përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë, janë personalitete të njohura në fushën e shkencës e të kërkimit shkencor, të caktuar nga Konferenca e Rektorëve.

Anëtarët e këtij këshilli, përfaqësues të qendrave të transferimit të teknologjive bujqësore janë personalitete të njohura në fushën e shkencës dhe kërkimit shkencor të caktuar nga ministri përgjegjës për bujqësinë.

Anëtarët e këtij këshilli qëndrojnë në detyrë për sa kohë ushtrojnë detyrën në institucionet e përfaqësuara sipas pikës 1, të këtij neni, apo nuk janë liruar nga ky këshill nga institucioni që i ka caktuar.

Organizimi, funksionimi, rastet e lirimit të anëtarëve dhe shpërblimi i këtij Këshilli përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11 parashikon detyrat e Këshillit Kombëtar për Shkencën dhe Kërkimin Shkencor, të cilat janë:

- Orienton politika mbështetëse për shkencën dhe kërkimin shkencor;
- Rekomandon fushat prioritare të shkencës e të kërkimit shkencor dhe mekanizmat e mbështetjes;
- Jep mendim në hartimin Strategjisë Kombëtare të Shkencës dhe Kërkimit Shkencor apo dokumenteve të ngjashme, si programet afatmesme e afatgjata të zhvillimit të shkencës e inovacionit për fusha të rëndësishme të shkencës;
- Monitoron sistemin kombëtar të shkencës dhe kërkimit shkencor si dhe ecurinë drejt integritit të sistemit në zonën evropiane të kërkimit (ERA), duke rekomanduar përmirësimin e tij sipas rastit.

Kreu III parashikon, nga nenet 12 deri 16, organizimin institucional të kërkimit shkencor.

Neni 12 përfshin institucionet, institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor. Kërkimi shkencor në Republikën e Shqipërisë realizohet nga persona juridikë, publikë ose jopublikë, të organizuar në institucione të kërkimit shkencor, institute dhe njësi të veçanta të kërkimit shkencor, të ngritura për të kryer veprimtari në fushën e shkencës dhe kërkimit shkencor.

Institucionet, pranë të cilave kryhet veprimtaria e kërkimit shkencor, që organizohen dhe funksionojnë sipas akteve ligjore të posaçme, janë:

a) Akademia e Shkencave;

- b) institucionet e arsimit të lartë;
- c) parqet teknologjike dhe shkencore;
- ç) qendrat e transferimit të teknologjive;
- d) institucione të tjera të krijuara me ligje të posaçme.

Instituti i kërkimit shkencor përbëhet nga jo më pak se dy njësi të kërkimit shkencor, të organizuara në formën e departamentit, qendrës kërkimore, laboratorit kërkimor ose qendrës eksperimentale, që zhvillojnë e mbështesin veprimtarinë kërkimore-shkencore në përputhje me këtë ligj.

Njësitë e kërkimit shkencor të organizuara në formën e departamentit, qendrës kërkimore, laboratorit kërkimor dhe qendrës eksperimentale ushtrojnë aktivitetin si pjesë përbërëse e instituteve të kërkimit shkencor.

Njësitë e veçanta të kërkimit shkencor organizohen si njësi të kërkimit shkencor, që realizojnë kërkim shkencor në fusha të veçanta të organizuara sipas legjislacionit në fuqi.

Për interesa të përbashkët kërkimorë, studimorë dhe zhvillimorë, institutet apo njësitë e kërkimit shkencor mund të krijojnë bashkëpunime në kuadër të marrëveshjeve të përbashkëta në përputhje me aktet rregullatore të tyre.

Neni 13 parashikon Institutin e Kërkimit Shkencor. Organet drejtuese të Institutit të Kërkimit Shkencor janë Këshilli Shkencor dhe drejtuesi i institutit të kërkimit shkencor, i cili i përket të paktën kategorisë “kërkues shkencor i avancuar”.

Këshilli Shkencor i Institutit të Kërkimit Shkencor është organi më i lartë vendimmarrës për drejtimin dhe vlerësimin e veprimtarisë shkencore të tij.

Këshilli Shkencor përbëhet nga jo më pak se 5 anëtarë, që përfaqësojnë njësitë përbërëse të Institutit të Kërkimit Shkencor.

Këshilli Shkencor i Institutit të Kërkimit Shkencor ka këto kompetenca:

- a) Përcakton politikat dhe planin strategjik, të lidhura me fushat e kërkimit shkencor në përputhje me misionin e Institutit të Kërkimit Shkencor;
- b) Miraton rregulloren e brendshme të Institutit të Kërkimit Shkencor;
- c) Miraton raportin, planin vjetor dhe afatmesëm të veprimtarisë kërkimore-shkencore;
- ç) Shqyrton e miraton marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, në përputhje me fushën e tij të veprimtarisë;
- d) Miraton rregulloren e komitetit të etikës;

dh) Nxit dhe mbështet zhvillimin e karrierës profesionale të punonjësve kërkimorë-shkencorë.

Përbërja, organizimi, mënyra e përzgjedhjes dhe kompetencat e tjera të Këshillit Shkencor përcaktohen në rregulloren e Këshillit.

Drejtuasi i Institutit të Kërkimit Shkencor zgjidhet ose emërohet sipas përcaktimeve në statutin përkatës apo në aktin e krijimit.

Drejtuasi i institutit kërkimor është përfaqësuesi i tij dhe drejton Këshillin Shkencor.

Struktura, përbërja, funksionimi dhe drejtimi i institutit përcaktohen në aktin e krijimit të tij dhe në statut.

Neni 14 parashikon njësitë e veçanta të kërkimit shkencor. Njësitë e veçanta të kërkimit shkencor organizohen si departamente, qendra kërkimore, laboratorë kërkimorë ose qendra eksperimentale dhe ushtrojnë aktivitetin pa qenë pjesë e një institucioni të krijuar me ligj të posaçëm ose e një instituti kërkimor-shkencor.

Organi drejtues i njësisë së veçantë të kërkimit shkencor është drejtuesi i njësisë, i cili i përket të paktën kategorisë “kërkues shkencor”. Procedura e emërimit dhe largimit të drejtuesit të njësisë përcaktohen në aktin e krijimit.

Njësitë e veçanta të kërkimit shkencor kanë në përbërje të tyre jo më pak se tre anëtarë, nga të cilët dy anëtarë i përkasin të paktën të kategorisë “kërkues shkencor” dhe një anëtar “asistent kërkues shkencor”.

Struktura, përbërja, funksionimi dhe drejtimi i njësisë së veçantë të kërkimit shkencor përcaktohen në aktin e krijimit.

Neni 15 parashikon bashkëpunimin e institucioneve, instituteve dhe njësisve të veçanta të kërkimit shkencor. Institucionet e krijuara me ligje të posaçme, institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor bashkëpunojnë me njëra-tjetrën, si dhe me institucione e njësi të tjera, publike ose jopublike, vendase ose të huaja, qendrat e transferimit të teknologjive, parqet teknologjike, njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit, me qëllim realizimin e misionit të tyre në fushën e kërkimit shkencor.

Me institucionet e arsimit të lartë bashkëpunimi bëhet kryesisht me qëllim:

a) zhvillimin e programeve të studimit të ciklit të dytë dhe të tretë nëpërmjet vënies në dispozicion të infrastrukturës dhe burimeve njerëzore;

- b) zhvillimin e projekteve të përbashkëta të kërkimit shkencor;
- c) zhvillimin e teknologjisë dhe inovacionit të produkteve në një fushë të caktuar me interes specifik në zhvillimin ekonomik e social;
- ç) shkëmbimin e informacionit, dijeve, inovacionit dhe produkteve të kërkimit.

Në kreun IV parashikohet, nga nenet 16 deri 22, krijimi, regjistrimi, lejimi, mbyllja dhe vlerësimi i instituteve dhe i njësive të veçanta të kërkimit shkencor.

Neni 16 parashikon krijimin e instituteve e të njësive të veçanta të kërkimit shkencor. Institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor krijohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe e fillojnë ushtrimin e aktivitetit me hyrjen në fuqi të aktit të krijimit. Institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor pjesë e institucioneve të krijuara me ligj të posaçëm, krijohen dhe e ushtrojnë aktivitetin sipas përcaktimeve në ligjin e krijimit.

Në aktin e krijimit të institutit apo njësisë së veçantë të kërkimit shkencor përcaktohen, të paktën:

- a) lloji;
- b) emri dhe selia;
- c) misioni, objekti dhe fusha e veprimtarisë;
- ç) struktura organizative.

Riorganizimi i brendshëm i institutit dhe i njësive të veçanta të kërkimit shkencor bëhet me propozim të një ose të disa njësive përbërëse dhe me miratim të organit, që miraton strukturën dhe organikën.

Institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor jopublik krijohen dhe funksionojnë me vendim të Këshillit të Ministrave.

Kriteret dhe procedurat për krijimin e institutit ose të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor, sipas përcaktimeve të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 17 parashikon statutin dhe aktet e brendshme të instituteve dhe njësive të veçanta të kërkimit shkencor. Institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor rregullojnë veprimtarinë e tyre në bazë të këtyre akteve:

- Statutit, i cili përmban normat bazë, që rregullojnë veprimtarinë e institutit dhe njësisë së veçantë të kërkimit shkencor dhe miratohet nga organi drejtues i tij. Në statut, në përputhje me aktin e krijimit së institutit apo njësisë së veçantë të kërkimit shkencor, përcaktohen: organizimi, strukturat përbërëse të tij,

veprimtaritë e organeve drejtuese, zgjedhja apo emërimi i tyre, si dhe çështje të tjera, që rregullojnë veprimtarinë e tyre.

- Rregulloreve të instituteve dhe njësive të veçanta të kërkimit shkencor, që rregullojnë veprimtarinë e tyre të brendshme në zbatim të ligjit, statutit e programit të tij. Ato hartohen dhe miratohen në përputhje me këtë ligj dhe sipas mënyrës së përcaktuar në statutin e institutit dhe njësive të veçanta të kërkimit shkencor.
- Kodit të etikës së institutit dhe të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor, që miratohet në përputhje me parimet e përgjithshme të etikës dhe integritetit në kërkimin shkencor, nga struktura drejtuese e entitetit.
- Dokumentit strategjik, që përcakton vizionin, misionin, objektivat afatgjatë të institutit dhe njësisë së veçantë të kërkimit shkencor, në zbatim të strategjisë kombëtare të kërkimit shkencor.
- Planit për barazinë gjinore, që nxit pjesëmarrje e trajtim të barabartë gjinor në organizimin e organeve drejtuese dhe veprimtaritë kërkimore.

Neni 18 parashikon Regjistrin Kombëtar të Institucioneve, instituteve, njësive të veçanta të kërkimit shkencor dhe kërkuesve shkencorë, i cili është regjistër unik, ku regjistrohen dhe ruhen të dhëna për institucionet e kërkimit shkencor dhe kërkuesit shkencorë. Ky regjistër mbahet e administrohet nga ministria.

Në këtë regjistër pasqyrohen të dhënat e aktit të krijimit të institucionit të krijuar me ligj të posaçëm, instituteve dhe njësive të veçanta të kërkimit shkencor, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin përkatës të ministrit.

Forma, përmbajtja, elementet e regjistrit dhe procedurat e krijimit, administrimit të informacionit, si dhe dokumentacioni që depozitohet për regjistrim përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 19 parashikon lejen për ushtrimin e një veprimtarie të një fushe të rëndësie të veçantë. Institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor, që krijohen për të ushtruar veprimtarinë e tyre në fusha të një rëndësie të veçantë, pajisen me lejen përkatëse nga ministria përgjegjëse për shkencën.

Me këtë leje pajisen edhe institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor, të cilat shtojnë në aktivitetin e tyre veprimtarinë në fushat e një rëndësie të veçantë të kërkimit shkencor, të cilat plotësojnë kriteret.

Fushat e rëndësisë së veçantë të kërkimit shkencor, për të cilat kërkohet leje e veprimtarisë kërkimore-shkencore, si dhe kriteret e procedurat për lëshimin e lejes përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 20 parashikon vlerësimin e instituteve dhe të njësive të veçanta të kërkimit shkencor. Institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor, të cilat financohen nga fonde publike, sipas këtij ligji, i nënshtrohen periodikisht vlerësimit të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve të funksionimit nga ministria.

Kriteret, procedurat, periodiciteti dhe metodologjia e këtij vlerësimi, si dhe llojet e masave miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 21 parashikon pezullimin, mbylljen e institutit dhe të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor. Në rast se nga kontrolli i ministrisë konstatohet që instituti ose njësia e veçantë e kërkimit shkencor nuk përmbush kriteret e funksionimit, ministri vendos kushte për vijimin e veprimtarisë nën mbikëqyrje të ministrisë ose pezullimin e veprimtarisë deri në plotësimin e kushteve, për një periudhë jo më të gjatë se dy vite kalendarike.

Veprimtaria e institutit ose e njësisë së veçantë të kërkimit shkencor mbyllet me propozimin e ministrit, nga institucioni krijues, në rastet e mëposhtme:

- a) Me iniciativën e tij;
- b) Në rastet e mbarimit të personalitetit juridik të institutit ose të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor kur gëzon personalitet juridik, sipas parashikimeve ligjore;
- c) Për shkak të shkeljeve të rënda ligjore në kryerjen e veprimtarisë së tij, të konstatuara nga kontrolli i ligjshmërisë, i cili realizohet së paku një herë në tre vite nga ministria;
- ç) Për shkak të mospërmbushjes së misionit për 24 muaj nga data e hyrjes në fuqi të aktit të krijimit;
- d) Për shkak të vlerësimit negativ të përsëritur pa ndërprerje;
- dh) Në rastin e konstatimit të shkeljeve nga auditimi financiar i cili realizohet së paku një herë në dy vite nga ministria.

Akti për mbylljen e institutit ose të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor depozitohet pranë Regjistrat Kombëtar të Institucioneve dhe Kërkuesve Shkencorë.

Rregullat dhe procedurat për vendosjen nën mbikëqyrje, pezullimin dhe mbylljen e institutit e të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor, sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2, të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 22 parashikon statusin e “qendrës së ekselencës” dhe “njësive të posaçme”. Instituti dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor, për rezultate të spikatura në nivel kombëtar ose ndërkombëtar në fushën e kërkimit apo për zhvillimin e kërkimit shkencor në fusha prioritare mund të fitojnë statusin “qendër ekselence”.

Institutet apo njësitë e veçanta me statusin “qendër ekselence” mund të përfitojnë fonde të posaçme apo fonde shtesë nga buxheti i shtetit, të dedikuara për kërkimin shkencor.

Statusi “qendër ekselence” propozohet nga ministri për një afat kohor të përkohshëm apo të përhershëm dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Kriteret dhe procedurat për dhënien e statusit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Struktura të ndryshme publike të kërkim-zhvillimit mund të fitojnë statusin “njësi e posaçme”, si njësi që, krahas veprimtarisë kërkimore kryesisht në zbatim, eksperimentimin e përhapjes së arritjeve, produkteve e teknologjive të reja, mund të kryejnë edhe funksion mësimdhënës në përgatitjen e specialistëve e kërkuesve të rinj në fusha specifike, në bashkëpunim me institucionet publike të arsimit të lartë të fushës së kërkimit, në nivelet e ciklit të dytë e të tretë të studimeve, si dhe në kuadër të veprimtarive shkencore të aplikuara në fushën ku zhvillojnë aktivitetin e kërkimit.

“Njësia e posaçme” mund të financohet drejtpërdrejt nga ministria e linjës, institucioni publik i arsimit të lartë, institucione publike dhe jopublike apo subjekte private biznesi nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit në kuadër të veprimtarive të kërkim-zhvillimit.

“Njësia e posaçme” mund të sigurojë të ardhurat e veta nëpërmjet shërbimeve të kualifikuara për të tretë sipas tarifave të miratuara nga organet e saj drejtuese. Statusi “njësi e posaçme” jepet me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të ministrit përgjegjës për shkencën dhe fushën përkatëse të kërkimit, pas marrjes së mendimit nga institucioni publik i arsimit të lartë. Masa dhe mënyra e pagesës për stafin akademik dhe atë kërkimor-shkencor të angazhuar nga IAL-të përcaktohet në status. Modalitetet dhe procedurat e bashkëpunimit midis njësisë, institucionit publik të arsimit të lartë dhe subjektit privat, në rast se ka të tillë, rregullohen me marrëveshje të përbashkët ndërmjet palëve.

Kreu V përfshin nenet nga 23 deri në 29, ku parashikohet rregullimi ligjor i personelit kërkimor-shkencor.

Neni 23 parashikon personelin e instituteve dhe njësive të veçanta të kërkimit shkencor.

Personeli i instituteve dhe i njësive të veçanta të kërkimit shkencor përbëhet nga punonjës kërkimorë-shkencorë, punonjës ndihmësteknikë dhe administrativë. Rregullimi i marrëdhënieve të punësimit ndërmjet palëve përcaktohet në kontratën e punës, e cila nënshkruhet nga drejtuesi i tyre, në përputhje me Kodin e Punës, me kohëzgjatje të caktuar ose të pacaktuar, si edhe me angazhim me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme.

Procedurat e rekrutimit përcaktohen në rregulloret e brendshme të tyre. Për institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor jopublik personeli kërkimor-shkencor rekrutohet sipas përcaktimeve në statutet dhe në rregulloret e brendshme të tyre.

Institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor kanë të drejtë të punësojnë për periudha të shkurtra kohe kërkues, studiues, personalitete në fushën e shkencës dhe kërkimit shkencor, vendas ose të huaj. Personeli i ftuar punësohet dhe shpërblehet sipas përcaktimeve në statut, rregulloret e institutit/njesisë së veçantë dhe në përputhje me legjislacionin e punës në Republikën e Shqipërisë.

Niveli i pagës dhe kategorizimet në pagë të personelit të instituteve dhe njësive të veçanta të kërkimit shkencor publik përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas legjislacionit në fuqi të fushës përkatëse. Për institucionet e krijuara me ligj të veçantë përcaktohen në ligjin e krijimit. Për institutet, njësitë e veçanta të kërkimit shkencor jopublike, niveli i pagës dhe kategorizimet në pagë përcaktohen në kontratën e punës ndërmjet palëve.

Neni 24 parashikon të drejtat dhe detyrat e punonjësit kërkimor-shkencor. Punonjësi kërkimor-shkencor ka të drejtë: të zgjedhë lirshëm drejtimin dhe metodën e kërkimit shkencor, sipas synimeve të tij shkencore, si dhe në funksion e përputhje me veprimtarinë dhe misionin e institutit ose të njesisë së veçantë pranë të cilit është i punësuar; të marrë pjesë në formimin e kërkuesve dhe specialistëve të lartë për fushën përkatëse nëpërmjet aktivitetit të mësimdhënies në të gjitha ciklet e studimit, si dhe udhëheqjeve në ciklin e dytë ose të tretë në përputhje me kriteret e akteve nënligjore përkatëse; të ketë mbështetjen e nevojshme financiare për realizimin e planit të punës kërkimore-shkencore dhe promovimin e tij në karrierë; të ketë kushtet e duhura logjistike dhe të punës në kryerjen e veprimtarisë së tij kërkimore-shkencore; të marrë pjesë në kurse kualifikimi, shkëmbim përvoja ose veprimtari kërkimore-shkencore pranë institucioneve homologe dhe të tjera të ngjashme, brenda ose jashtë vendit; të vlerësohet dhe të shpërblehet për punën e tij në bazë të cilësisë dhe rëndësisë së rezultateve, në kuadër të pjesëmarrjes në veprimtari dhe projekte të kërkimit shkencor. Niveli dhe mënyra e shpërblimit përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës të shkencës dhe kërkimit shkencor; të publikojë rezultatet e punës së

tij kërkimore; të gëzojë të drejtat e tij intelektuale të rezultateve dhe botimeve të tij, sipas legjislacionit përkatës e parashikimeve kontraktore me institucionin ku është punësuar. Punonjësi kërkimor-shkencor ka detyrimin të zbatojë statutin dhe rregulloren e institucionit kërkimor-shkencor; të respektojë kodin e etikës; të zbatojë programin e veprimtarisë kërkimore-shkencore; të respektojë parimet e shkencës së hapur; të ndjekë programet e detyrueshme të kualifikimit të përcaktuara me aktet e brendshme të institucionit të kërkimit shkencor. Të drejtat dhe detyrimet të tjera të punonjësve përcaktohen në statutet dhe aktet përkatëse të institucionit, në përputhje me këtë ligj.

Neni 25 parashikon kategoritë e punonjësve kërkimorë-shkencorë dhe kriteret për fitimin e kategorive. Punonjësit kërkimorë-shkencorë klasifikohen në kategoritë e mëposhtme: asistent kërkues shkencor; kërkues shkencor; kërkues shkencor i avancuar; drejtues kërkimor-shkencor. Kriteret dhe procedurat për përfitimin e kategorisë nga punonjësit kërkimorë-shkencorë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 26 parashikon akordimin e titullit “shkencëtar *emeritus*” për punonjësit e kategorisë “drejtues kërkimor-shkencor”, pas daljes në pension, në vlerësim të veprimtarisë tyre të spikatur kërkimore-shkencore, pas marrjes së pëlqimit nga Ministri. “Shkencëtari *emeritus*”, sipas nevojave të institutit apo të njësisë së veçantë kërkimore-shkencore, mund të marrë pjesë në veprimtari të kërkimit shkencor. Institucionet e kërkimit shkencor, që organizohen dhe funksionojnë sipas ligjeve të posaçme, akordojnë tituj sipas përcaktimeve në ligjin e krijimit.

Neni 27 parashikon lëvizshmërinë e punonjësit kërkimor-shkencor. Punonjësi kërkimor-shkencor, në kuadër të një projekti apo marrëveshjeje bashkëpunimi, mund të ushtrojë veprimtarinë e tij kërkimore-shkencore jashtë vendit për një periudhë të caktuar kohore. Kriteret, rregullat e kohëzgjatjes së periudhës së qëndrimit, marrëdhëniet administrative dhe raportet e punonjësit me institucionin, ku do të angazhohet, përcaktohen me marrëveshje ndërmjet palëve, bazuar në aktet e brendshme të institutit apo të njësisë së veçantë ku është punësuar.

Punonjësi kërkimor-shkencor i huaj mund ushtrojë veprimtarinë e tij kërkimore-shkencore pranë një institucioni të krijuar me ligj të posaçëm, instituti apo njësie të veçantë kërkimore-shkencore në kuadër të një projekti apo marrëveshjeje bashkëpunimi, për një periudhë të caktuar kohe, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të tyre.

Neni 28 parashikon periudhën sabatike, nëpërmjet së cilës punonjësi kërkimor-shkencor ka të drejtë të shkëputet nga angazhimet e institutit apo njësisë

së veçantë kërkimore-shkencore, për përparimin e tij profesional, një herë në 7 (shtatë) vjet, për periudha kohe deri në 1 (një) vit kalendarik.

Miratimi i periudhës sabatike bëhet nga titullari i institutit apo i njësisë së veçantë. Të drejtat dhe detyrimet e përfituesit të periudhës sabatike përcaktohen në statut dhe në rregulloret e brendshme.

Neni 29 parashikon vlerësimin e veprimitarisë së punonjësit kërkimor-shkencor. Rezultatet e veprimitarisë së punonjësit kërkimor-shkencor vlerësohen në vazhdimësi në mënyrë periodike në institutin apo në njësinë e veçantë kërkimore-shkencore, ku ushtron aktivitetin, prej strukturave të ngritura për këtë qëllim.

Kriteret për vlerësimin e veprimitarisë kërkimore-shkencore të punonjësit kërkimor-shkencor përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Kreu VI parashikon, nga nenet 30 deri 32, integritetin në shkencë dhe kërkimin shkencor.

Neni 30 parashikon krijimin e Kodit të Etikës në Shkencë dhe Kërkim Shkencor, që është dokumenti kryesor për garantimin e vlerave të kërkimit shkencor, për të gjitha institutet apo njësitë e veçanta kërkimore-shkencore, ku kryhet veprimtari kërkimore-shkencore. Kodi i etikës miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Kodi i Etikës në Shkencë dhe Kërkim Shkencor përmban:

- a) parimet themelore të etikës në shkencë dhe kërkim;
- b) praktikat e mira të shkencës dhe kërkimit;
- c) llojet e shkeljeve dhe të masave disiplinore, si dhe procedurat për dhënien e tyre, në rastin e shkeljeve të etikës në shkencë dhe kërkim;
- ç) risqet dhe sistemin e menaxhimit të tyre në shkencë e në kërkim shkencor.

Çdo institut apo njësi e veçantë kërkimore-shkencore respekton kodin e etikës, duke përcaktuar procedurat specifike në zbatim të tij.

Neni 31 parashikon ngritjen e Komitetit të Etikës në Kërkimin Shkencor. Ky komitet ngrihet pranë instituteve apo njësisive të veçanta kërkimore-shkencore, të parashikuara në këtë ligj, dhe vepron në bazë të Kodit të Etikës dhe rregulloreve përkatëse të miratuara nga vetë ato. Në përbërje të tij mund të përfshihen edhe ekspertë të jashtëm, sipas përcaktimeve të bëra në rregulloret e tyre.

Komiteti i Etikës në Kërkimin Shkencor vlerëson plotësimin e kriterëve për shmangien e riskut në kërkimin shkencor, në përputhje me Kodin e Etikës. Risku i kërkimit vlerësohet në çdo projekt kërkimor dhe ndryshim të tij, për veprimtaritë dhe produktin e kërkimit shkencor.

Komiteti i Etikës në Kërkimin Shkencor propozon masat disiplinore sipas parashikimeve të dispozitave të këtij ligji.

Përbërja dhe funksionimi i Komitetit të Etikës në Kërkimin Shkencor rregullohet me aktet e brendshme të institutit apo njësisë së veçantë të kërkimit shkencor.

Neni 32 parashikon shkeljet dhe masat disiplinore në kërkimin shkencor. Plagjiatura, falsifikimi dhe fabrikimi i rezultateve të kërkimit shkencor përbëjnë shkelje të rënda të etikës në kërkimin shkencor.

Masat këshilluese dhe ato disiplinore ndaj punonjësve, që shkelin etikën në kërkim shkencor, propozohen nga Komiteti i Etikës dhe jepen nga titullari i institutit apo njësisë së veçantë të kërkimit shkencor, bazuar në kodin e etikës në kërkimin shkencor.

Masa disiplinore më e rëndë është shfuqizimi i kategorisë së punonjësit të kërkimit shkencor, e cila jepet vetëm për shkelje të rënda të etikës së kërkimit shkencor.

Punonjësi kërkimor-shkencor, të cilit i është shfuqizuar kategoria, mund të aplikojë për të njëjtën kategori, pas kalimit të 3 (tre) vjetëve nga akti i shfuqizimit.

Kreu VII parashikon, nga nenet 33 deri 37, financimin e kërkimit shkencor dhe të inovacionit.

Neni 33 parashikon burimet e financimit. 1. Institutet/ njësitë e veçanta, qendrat e ekselencës dhe njësitë e posaçme të kërkimit shkencor financohen me fonde nga:

- a) buxheti i shtetit;
- b) projektet ndërkombëtare të kërkimit shkencor dhe inovacionit;
- c) të ardhura nga veprimtari të kërkimit shkencor dhe inovacionit;
- ç) të ardhura nga shërbime tekniko-shkencore për të tretët;
- d) të drejtat e pronësisë intelektuale si patentat, shpikjet, veprat e ndryshme etj.;
- dh) të ardhura nga aplikimi në praktikë i rezultateve të veprimtarisë kërkimore dhe inovacionit nga institutet edhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor;
- e) dhurime nga donatorë të ndryshëm;
- ë) burime ose veprimtari të tjera të ligjshme.

Institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor janë të detyruara të sigurojnë një përdorim sa më efektiv dhe ekonomik të burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë.

Burimet financiare të vëna në dispozicion të instituteve dhe njërive të veçanta të kërkimit shkencor nga organizma jopublike ose ndërkombëtare përdoren vetëm për përmbushjen e misionit dhe objektivave të tyre.

Për institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet e tjera publike, të cilat aktualisht ushtrojnë veprimtari në fushën e kërkimit shkencor dhe organizohen me ligj të veçantë, burimet e financimit rregullohen sipas ligjit përkatës dhe përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 34 parashikon mënyrën e financimit nga buxheti i shtetit dhe kategorizimin e fondeve buxhetore për institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet e tjera publike, të cilat aktualisht ushtrojnë veprimtari në fushën e kërkimit shkencor, në përputhje me legjislacionin specifik të fushave, ku ushtrojnë veprimtarinë dhe përcaktimet e këtij ligji. Institucionet e krijuara me ligj të veçantë financohen sipas përcaktimeve në ligjin e krijimit.

Burimet financiare për veprimtarinë e kërkimit shkencor për institucionet, institutet dhe njësitë e veçanta, publike të kërkimit shkencor planifikohen, miratohen, administrohen, pasqyrohen dhe raportohen, sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Neni 35 parashikon financimin për programet apo projektet kërkimore. Institucionet e krijuara me ligj të posaçëm, institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor publike dhe jopublike financohen mbi baza konkurruese të programeve apo projekteve kërkimore që paraqesin për financim pranë ministrisë apo institucionit përgjegjës të varësisë. Për përdorimin e fondeve publike, ato i nënshtrohen auditimit financiar.

Neni 36 parashikon bashkëfinancimin e projekteve kërkimore. Institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor për projekte kërkimore të veçanta mund të financohen nga fonde të krijuara nga bashkimi i dy ose më shumë burimeve si buxheti i shtetit, financime të ligjshme nga subjekte jopublike dhe financime të ligjshme nga institucione ndërkombëtare.

Masa dhe mënyra e financimit rregullohen në marrëveshjen ndërmjet dy ose më shumë palëve, që lidhin institucionet dhe njësitë e kërkimit shkencor.

Neni 37 parashikon administrimin e aseteve. Institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor kanë në administrim ose në pronësi godinat, ku zhvillojnë aktivitetin, pajisjet, revistën, bibliotekën, muzeun, produkte të krijimtarisë intelektuale. Këto institucione, gjatë aktivitetit të tyre, krijojnë apo zhvillojnë asete financiare apo fizike nëpërmjet burimeve të ligjshme të financimit.

Pronat e paluajtshme, në të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre institutet dhe njësitë e veçanta publike, të kërkimit shkencor, që shërbejnë për të garantuar përmbushjen e misionit të institucionit, kalojnë në administrim të tij, me vendim të Këshillit të Ministrave.

Institutet dhe njësitë e veçanta publike të kërkimit shkencor kanë detyrimin të ruajnë e të mirëmbajnë pronat në administrim dhe nuk mund të ndryshojnë destinacionin e tyre.

Kreu VIII parashikon dispozitat kalimtare dhe të fundit.

Neni 38 parashikon se të gjitha institucionet, institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor të krijuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë detyrimin të depozitojnë informacionin dhe dokumentacionin në përputhje me elementet e Regjistrisë Kombëtare të Institucioneve dhe Kërkuesve Shkencorë brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Vlerësimi i parë i instituteve apo i njërive të veçanta të kërkimit shkencor ekzistues bëhet brenda 3 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Aktet nënligjore të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk bien ndesh me të do të zbatohen derisa nuk janë miratuar aktet nënligjore të parashikuara në këtë ligj.

Neni 39 parashikon aktet nënligjore në zbatim të përcaktimeve të këtij projektligji.

Neni 40 parashikon shfuqizimin e ligjit aktual nr.7893, datë 22.12.1994, “Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik”, të ndryshuar.

Neni 41 parashikon hyrjen në fuqi të ligjit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen ministria përgjegjëse për shkencën dhe institucionet e kërkimit shkencor.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji “Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë” është hartuar dhe koordinuar nga MAS-i me kontributin e grupit të punës, ngritur me urdhrin nr.57, datë 25.3.2022, të Kryeministrit, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit “Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”.

Pjesë e grupit të punës kanë qenë përfaqësues të Konferencës së Rektorëve, Akademisë së Shkencave, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës, Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë.

Në kuadër të detyrimit të konsultimit publik, projektligji “Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë” është publikuar dhe për këtë projektligj ka përfunduar konsultimi për draftin e parë. Komentet e depozituara në kuadër të procesit të bashkërendimit me Konferencën e Rektorëve dhe Akademinë e Shkencave janë reflektuar në projektligj, ndërsa në regjistrimin e njoftimeve dhe konsultimeve publike nuk ka pasur sugjerime.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Në nenin 35, të projektligjit, parashikohet se financimi nga buxheti i shtetit për institucionet, institutet dhe njësitë e veçanta publike të kërkimit shkencor do të jetë në formë granti si transfertë e pakushtëzuar për ushtrimin e veprimtarisë së tyre, ndërsa ndarja e grantit bëhet nga ministria nëpërmjet institucionit përgjegjës në varësi mbi baza konkurruese të programeve apo të projekteve kërkimore.

Burimet financiare për veprimtarinë e kërkimit shkencor për institucionet, institutet dhe njësitë e pavarura publike të kërkimit shkencor planifikohen, miratohen, administrohen, pasqyrohen dhe raportohen sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Kostimi i këtij projektligji është realizuar në harmoni të plotë dhe me kostimin e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin për periudhën 2023-2030, si kosto mesatare vjetore e aktiviteteve të parashikuara për periudhën 2023-2030, e cila, për vitin 2023, ishte në masën 0.084% ndaj produktit të brendshëm bruto, në vitin 2026 parashikohet të arrijë në masën 0.152% e PBB-së, e në vitin 2030 synon të arrijë në masën 0.162% e PBB-së.

Projektligji i propozuar nuk krijon institucione, institute apo njësi të tjera të reja, por krijon bazën ligjore të nevojshme për krijimin e tyre në rastet dhe sipas

përcaktimeve të këtij projektligji. Për këtë arsye, me hyrjen në fuqi të këtij projektligji nuk lind detyrimi për të financuar institucione të reja nga buxheti i shtetit.

[Shqiptaria.com]

Tabela 2: Kostimi i objektivave të Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin për periudhën 2023-2030, sipas aktiviteteve të parashikuara për çdo aktivitet

Qëllimi i politikës I: Rritja e efikasitetit dhe e qëndrueshmërisë së sistemit për mbështetjen e kërkimit shkencor, te integruar ne nivel ndërkombëtar, në të gjithë spektrin e fushave të shkencave natyrore, inxhinierike dhe teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale dhe humane											
Nr.	Titulli	Institucionet Përgjegjës		Periudha e Zbatimit		Kosto indikative					
		Institucioni drejtues	Institucionet pjesëmarrëse	Data e fillimit	Data e mbarimit	Korente	Kapitale	Total Kosto	Total BSH	Total FH	Hendeku financiar
1.1	I. Objektiv i specifik Plotësimi dhe zbatim i kuadrit ligjor dhe rregullator për të garantuar cilësinë, etikën dhe efektivitetin në zhvillimin dhe aplikimin e kërkimit në përputhje me fushat prioritarë	MAS, AKKSHI	AKKSHI, IAL, MFE, ASCAL, ASHSH, RASH, ASHSH, ML	2023	2030						
1.1.1	1.1.1 Masa 1 Miratimi i ligjit të ri "Për shkencën në Republikën e Shqipërisë"	MAS	AKKSHI, IAL, MFE, ASCAL, ASHSH	2023	2023	2,028,830	0	2,028,830	2,028,830	0	0
1.1.2	1.1.2 Miratimi i paketës së akteve nënligjore në zbatim të Ligjit të ri "Për Shkencën në Republikën e Shqipërisë"	MAS	AKKSHI, ASHSH, IAL	2024	2024	2,612,986	0	2,612,986	2,612,986	0	0
1.1.3	1.1.3 Zhvillimi i fushatave sensibilizuese për ligjin "Për shkencën në Republikën e Shqipërisë".	MAS	AKKSHI, IAL	2024	2024	69,969	0	69,969	69,969	0	0
1.1.4	1.1.4 Masa 4 Krijimi i një strukture koordinuese kombëtare për politikën mbi shkencën, teknologjinë dhe inovacionin	MAS	ML	2025	2025	1,670,925	0	1,670,925	95,928	0	-1,574,997
1.1.5	1.1.5 Masa 5 Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore lidhur me statusin e kërkuesit shkencor	MAS	AKKSHI, ASHSH, RASH, IAL	2024	2025	1,797,700	0	1,797,700	1,797,700	0	0
1.1.6	1.1.6 Masa 6. Hartimi dhe miratimi i Kodit të Etikës në Kërkimin Shkencor	MAS	AKKSHI	2024	2025	1,540,445	0	1,540,445	1,540,445	0	0
1.1.7	1.1.7 Masa 7. Hartimi i kriterëve dhe i treguesve për vlerësimin e kërkimit shkencor dhe renditja e IAL-ve sipas performancës në kërkimin shkencor	MAS	AKKSHI	2026	2030	3,764,555	0	3,764,555	3,764,555	0	0

1.1.8	1.1.8 Masa 8 Rishikimi i akteve ligjore në kuadër të kapitullit 25 të BE "Shkenca dhe kërkimi shkencor"	MAS	AKKSHI, RASH, IAL	2023	2030	17,724,232	0	17,724,232	16,024,232	1,700,000	0
1.1.9	1.1.9 Masa 9 Rishikimi i kuadrit rregullator përfshirë atë institucional për kërkimin shkencor në kuadër të detyrimeve që burojnë nga procesi i asociimit në BE lidhur me kapitullin 25 të BE "Shkenca dhe kërkimi shkencor"	MAS	AKKSHI, ASHSH	2023	2030	32,989,757	0	32,989,757	1,189,757	31,800,000	0
1.1.10	1.1.10 Masa 10 Përmirësimi i akteve normative lidhur me përcaktimin e fushave prioritare të kërkimit shkencor.	MAS	AKKSHI, IAL	2023	2030	11,872,020	0	11,872,020	11,272,024	0	-599,996
1.1.11	1.1.11 Masa 11 Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore që garantojnë aksesin në publikime të kërkuesve shkencorë të vendit për të qenë në linjë me strategjitë e <i>Open Access</i> , që zbatohen në nivel evropian	AKKSHI	MAS, ASHSH, RASH, IAL	2024	2025	7,384,591	0	7,384,591	6,664,592	0	-719,999
1.1.12	1.1.12 Masa 12 Hartimi i udhëzuesit për hartimin e planit për hendeqet gjinore në institucionet kërkimore-shkencore (përfshirë IAL)	MAS	AKKSHI, IAL	2023	2030	20,064,000	0	20,064,000	0	2,400,000	-17,664,000
1.1.12	1.1.13 Miratimi dhe vënia në zbatim (funksionalizimi) i rregullores për krijimin e regjistrit kombëtar të revistave dhe periodikëve shkencorë dhe për përcaktimin e kriterëve që duhet të plotësojnë revistat dhe periodikët shkencorë për t'u regjistruar në regjistrin kombëtar të Republikës së Shqipërisë.	MAS	IAL, AKKSHI, ASHSH, RASH	2023	2030	8,067,877	5,200,000	13,267,877	10,726,236	0	-2,541,641
Kosto Objektivi Specifik 1.1						111,587,887	5,200,000	116,787,887	57,787,254	35,900,000	-23,100,633
1.2	Objektivi Specifik 2 Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore dhe i infrastrukturës mbështetëse të kërkimit shkencor për rritjen e performancës në programet kombëtare dhe ndërkombëtare.	AKKSHI, MAS	IAL, Institutet kërkimore pranë ML, AMSHC, MAS, MB, AKFAL, RASH, ASHSH, MK, ML	2023	2030						

1.2.1	1.2.1 Masa 1 Ngritja e kapaciteteve për shkrimin e projekteve kombëtare shkencore, në mënyrë që përmbajtja dhe arritjet e tyre të kontribuojnë në cilësinë, rëndësinë dhe efektivitetin e kërkimit dhe përmbushjen e qëllimeve strategjike në fushat prioritare.	AKKSHI	MAS, IAL, Ministria e Mbrojtjes	2023	2030	10,500,000	0	10,500,000	3,180,000	0	-7,320,000
1.2.2	1.2.2 Masa 2 Organizimi i ditëve informative dhe i aktiviteteve promovuese për thirrjet e projekteve në programe ndërkombëtare	AKKSHI	IAL, Institutet kërkimore pranë ministrive të linjës, AMSHC	2023	2030	8,064,000	0	8,064,000	5,760,000	0	-2,304,000
1.2.3	1.2.3 Masa 3 Trajnimi i stafeve akademike lidhur me aplikimin në programe ndërkombëtare	MAS	AKKSHI,	2023	2030	2,981,069	0	2,981,069	823,438	0	-2,157,631
1.2.4	1.2.4 Masa 4 Ngritja dhe forcimi i qendrave kombëtare shkencore të ekselencës që integrojnë studiues dhe burime kërkimore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar	AKKSHI	MAS/IAL	2023	2030	0	15,450,000,000	15,450,000,000	8,350,000,000	2,830,000,000	-4,270,000,000
1.2.5	1.2.5 Masa 5 Krijimi i Hartës Kombëtare të infrastrukturës së Kërkimit Shkencor në Shqipëri në përputhje me ESFRI (<i>European Strategic Framework of Research Infrastructure</i>)	AKKSHI	MAS	2024	2026	3,663,813	50,000,000	53,663,813	2,463,813	0	-51,200,000
1.2.6	1.2.6 Masa 6 Forcimi i sistemit të shkencës dhe kërkimit shkencor përmes bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar	AKKSHI	MAS, IAL ASHSH	2023	2030	12,902,400	0	12,902,400	12,902,400	0	0
1.2.7	1.2.7 Masa 7 Krijimi i rrjeteve të kërkuesve shkencorë brenda dhe jashtë Shqipërisë	AKKSHI	RASH	2023	2030	10,560,000	0	10,560,000	4,700,000	0	-5,860,000
1.2.8	1.2.8 Masa 8 Krijimi dhe përditësimi periodik i databazës së kërkuesve shkencore	RASH	IAL, AKKSHI, ASHSH	2024	2030	5,180,000	0	5,180,000	740,000	0	-4,440,000
1.2.9	1.2.9 Masa 9 Rritja e mbështetjes financiare për aplikimin në projekte kombëtare	AKKSHI	AKFAL, MK , ASHSH, AMSHC	2023	2030	4,005,201,563	6,325,000	4,011,526,563	4,001,241,560	0	-10,285,003
1.2.10	1.2.10 Masa 10 Forcimi i kapaciteteve të pikave kombëtare të kontaktit (programi "Horizon")	AKSHI (Fonde për	MAS, ASHSH	2023	2030	9,840,000	0	9,840,000	0	0	-9,840,000

		Shkencën) /									
1.2.11	1.2.11 Zhvillimi i Platformës (on-line) të të dhënave për kërkimit shkencor në RSH, në lidhje me kapacitetet njerëzore, infrastrukturure, biblioteka dhe arkiva	MAS, RASH /	AKKSHI, IAL, MK, ASHSH	2026	2030	10,489,200	12,000,000	22,489,200	0	0	-22,489,200
	Kosto Objektivi specifik 1.2					4,079,382,045	15,518,325,000	19,597,707,045	12,381,811,211	2,830,000,000	-4,385,895,834
1.3	Objektivi specifik 3 Përmirësimi i mbledhjes, përpunimit, interpretimit dhe publikimi i treguesve statistikore dhe të tjerë të kërkimit, zhvillimit të teknologjisë dhe inovacionit.	INSTAT, AKKSHI, ASPА	MAS, AKKSHI, Institucionet e kërkimit shkencor, IAL, MK,	2023	2030						
1.3.1	1.3.1 Masa 1. Hartimi i metodologjisë së mbledhjes së të dhënave statistikore në fushën e kërkimit shkencor	INSTAT	MAS, AKKSHI, Institucionet e kërkimit shkencor, IAL, MK	2023	2023	488,915	0	488,915	488,915	0	0
1.3.2	1.3.2 Masa 2. Hartimi dhe publikimi i të dhënave për kërkimin shkencor sipas periodicitetit të përcaktuar në programin e statistikave zyrtare 2022-2026	INSTAT	MAS, AKKSHI	2023	2030	204,234,810	1,750,000	205,984,810	204,234,810	1,750,000	0
1.3.3	1.3.3 Masa 3. Hartimi dhe publikimi i buletinit të përvitshëm për kërkimin shkencor	AKKSHI	MASR (Fonde për Shkencën)	2023	2030	1,071,423	0	1,071,423	1,071,423	0	0
1.3.4	1.3.4 Masa 4 Zhvillimi i kapaciteteve të stafit të MAS, AKKSHI dhe instituteve të tjera kërkimore për mbledhjen, analizën dhe raportimin e standardizuar të statistikave për kërkimin shkencor sipas standardeve ndërkombëtare (Eurostat, OECD).	ASPА	INSTAT	2024	2030	900,000	0	900,000	0	0	-900,000
1.3.5	1.3.5 Masa 5. Hartimi i treguesve të performancës mbi kërkimin shkencor me qëllim krahasimin në nivel evropian dhe ndërkombëtar	AKKSHI	MAS	2025	2030	3,339,434	0	3,339,434	683,279	0	-2,656,155

	Kosto Objektivi specifik 1.3					210,034,582	1,750,000	211,784,582	206,478,427	1,750,000	-3,556,155
	Kosto totale Qëllimi i politikës I (objektiva specifikë 1.1+1.2+1.3					4,401,004,514	15,525,275,000	19,926,279,514	12,646,076,892	2,867,650,000	-4,412,552,622
Qëllimi i politikës II: Krijimi i një mjedisi që lehtëson dhe inkurajon mekanizmat e ndërveprimit dhe transferimit të teknologjive për bashkëpunim midis komunitetit të kërkimit, ekonomisë, inovacionit dhe institucioneve publike											
Nr.	Titulli	Institucionet Përgjegjës		Periudha e Zbatimit		Kosto indikative					
		Institucioni drejtues	Institucionet pjesëmarrëse	Data e fillimit	Data e mbarimit	Korente	Kapitale	Total Kosto	Total BSH	Total FH	Hendeku Financiar
2.1	Objektivi specifik 1 Rritja e bashkëpunimit ndërmjet Institucioneve të Arsimit të Lartë, institucioneve të pushtetit qendror dhe pushtetit vendor, sektorit të biznesit dhe shoqërisë civile nëpërmjet zgjerimit të kërkimit dhe zhvillimit të projekteve të përbashkëta. (<i>Quadruple Helix Model</i>)	MFE, AKKSHI, MAS	AIDA, MSHNS, IAL, ML, NJQV	2023	2030						
2.1.1	2.1.1 Masa 1. Krijimi i skemave novatore për bashkëfinancimin e programeve të kërkimit shkencor që forcojnë bashkëpunimin me sektorin e biznesit për zgjidhjen e sfidave aktuale shoqërore	MFE	MAS, AIDA, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes	2023	2030	0	1,776,000,000	1,776,000,000	1,076,000,000	0	-700,000,000
2.1.2	2.1.2 Masa 2 Informimi dhe njohja e të gjitha grupeve të interesit me mekanizmat dhe instrumentet e financimit shkencor	AKKSHI	MFE, MAS, AIDA, IAL	2023	2030	8,639,852	0	8,639,852	5,503,908	0	-3,135,944
2.1.3	2.1.3 Promovimi i modeleve të kërkimit shkencor në pjesëmarrjen e projekteve të përbashkëta (<i>Quadruple Helix model</i>)	AKKSHI	MAS, Ministrinë e Linjës	2023	2030	7,960,190	0	7,960,190	2,081,376	0	-5,878,814
2.1.4	2.1.4 Hartimi i udhëzuesve (që përfshijnë edhe protokollat dhe procedurat) për projekte të përbashkëta	AKKSHI	MAS	2023	2024	1,680,000	0	1,680,000	0	0	-1,680,000
2.1.5	2.1.5 Forcimi i kapaciteteve të IAL, përfaqësuesve të biznesit, institucioneve qendrore dhe vendore për hartimin e projekteve të përbashkëta	AKKSHI	MAS, IAL, AIDA, MFE, ML, NJQV	2025	2030	13,082,924	0	13,082,924	185,291	0	-12,897,633

2.1.6	2.1.6 Fuqizimi i kapaciteteve të strukturave të vlerësimit të projekteve të kërkimit shkencor me qëllim përfaqësimin e biznesit në këto struktura	MAS	AKKSHI	2025	2030	2,974,462	0	2,974,462	382,462	0	-2,592,000
Kosto Objektivi specifik 2.1						34,337,428	1,776,000,000	1,810,337,428	1,084,153,037	0	-726,184,391
2.2	2.2 Objektivi specifik 2: Përmirësimi i mekanizmave dhe rritja e mbështetjes së transferimit ndërkombëtar të teknologjisë (TNT).	DPPI, AKKSHI, MFE	MFE MAS, MBZHR, IAL, MSHNS, ML,	2023	2030						
2.2.1	2.2.1 Plotësimi i bazës ligjore të nevojshme për transferimin ndërkombëtar të teknologjive (TNT)	DPPI	MAS, MFE dhe ML	2025	2030	7,550,166	0	7,550,166	6,315,364	0	-1,234,802
2.2.2	2.2.2 Fuqizimi i kapaciteteve të IAL-ve për transferimin ndërkombëtar të teknologjisë	AKKSHI	MFE MAS, MBZHR IAL, MSHMS,	2025	2030	3,390,803	0	3,390,803	1,149,202	0	-2,241,601
2.2.3	2.2.3 Zhvillimi i infrastrukturave të reja që mundësojnë transferimin ndërkombëtar të teknologjive	MFE	MAS, MBZHR IAL, MSHMS	2026	2030	25,084,665	29,894,200	54,978,865	0	29,342,200	-25,636,665
2.2.4	2.2.4 Promovimi i programeve ndërkombëtare që mbështesin transferimin e teknologjisë dhe njohja e të gjithë grupeve të interesit me mekanizmat, instrumentet e financimit/ mbështetjes së transferimit të ndërkombëtar të teknologjisë	AKKSHI	MAS, IAL, Ministrinë e Linjës	2024	2030	3,803,101	0	3,803,101	464,100	0	-3,339,001
2.2.5	2.2.5 Hartimi i udhëzuesve (që përfshijnë edhe protokollat dhe procedurat) për hartimin e projekteve të përbashkëta	AKKSHI	MAS	2026	2030	1,320,000	0	1,320,000	0	0	-1,320,000
Kosto Objektivi specifik 2.2						41,148,735	29,894,200	71,042,935	7,928,666	29,342,200	-33,772,069
2.3	2.3 Objektivi specifik 3: Rritja e rolit të shkencës dhe inovacionit në zhvillimin teknologjik	AKKSHI, AKFAL, MFE	MAS, DPPI, IAL, MBZHR, MIE, ML, AKSHI	2023	2030						
2.3.1	2.3.1 Përmirësimi i një udhëzuesi (guideline) për lëvrimin e granteve për financimin e programeve kombëtare të kërkimit zhvillimit dhe inovacionit	AKKSHI, AKFAL	MAS	2024	0	1,067,294	0	1,067,294	1,067,294	0	0

2.3.2	2.3.2 Promovimi i projekteve shkencore me ndikim në inovacion dhe zhvillimin teknologjik	AKKSHI	DPPI, IAL, MBZHR, MIE, ML	2023	2030	3,155,616	361,364,126	364,519,742	362,205,290	0	-2,314,452
2.3.3	2.3.3 Vlerësim i nevojave për zhvillimet teknologji/inovacion me qëllim orientimin e projekteve kombëtare	AKKSHI	DPPI, IAL, MBZHR, MIE, MAS, , AKKSHI, ML	2026	2030	2,689,194	0	2,689,194	0	0	-2,689,194
2.3.4	2.3.4. Hartimi i projekteve për krijimin e qendrave rajonale të teknologjisë dhe inovacionit me qëllim mbështetjen e zhvillimit teknologjik	MFE	IAL, Ministritë e Linjës, MIE	2026	2030	1,765,194	0	1,765,194	1,045,194	0	-720,000
Kosto Objektivi specifik 2.3						8,677,298	361,364,126	370,041,424	364,317,778	0	-5,723,646
2.4	2.4 Objektivi specifik 4: Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të qendrave të transferimit të teknologjisë për të avancuar njohuritë në një fushë të caktuar ose për të zhvilluar më tej teknologjinë	MBZHR, AKKSHI	IAL, MAS, MFE, MIE, DPPI, institute kërkimore jashtë IAL, ML	2023	2030						
2.4.1	2.4.1 Plotësimi i bazës ligjore për mirëfunksionimin e qendrave të transferimit të teknologjisë	MBZHR	IAL, MAS, MFE, MIE, DPPI, institute kërkimore jashtë IAL, ML	2023	2030	9,197,711	0	9,197,711	9,197,704	0	0
2.4.2	2.4.2 Fuqizimi i marrëdhënieve midis QTT dhe akademisë	MBZHR	IAL, AKKSHI	2023	2030	480,000	4,037,890,000	4,038,370,000	1,419,676,000	0	-2,618,694,000
2.4.3	2.4.3 Rritja e kapaciteteve të punonjësve të QTT mbi shkrimin e projekteve	AKKSHI	MBZHR	2024	2030	4,483,908	0	4,483,908	2,253,348	0	-2,230,560
2.4.4	2.4.4. Nxitja bashkëpunimit midis QTT dhe IAL përmes projekteve të përbashkëta	AKKSHI	IAL	2024	2030	4,658,908	70,000,000	74,658,908	73,882,906	0	-776,002
Kosto Objektivi specifik 2.4						18,820,527	4,107,890,000	4,126,710,527	1,505,009,958	0	-2,621,700,562
Kostoja totale Qëllimi i politikës II (objektiva specifike 2.1+2.2+2.3+2.4)						102,983,988	6,275,148,326	6,378,132,314	2,961,409,439	29,342,200	-3,387,380,668

Qëllimi i politikës 3 - Promovimi i kulturës së shkencës dhe inovacionit në edukim për të siguruar një qasje didaktike me theksin në praktikën kërkimore dhe projektet.

Nr.	Titulli	Institucionet Përgjegjës		Periudha e Zbatimit		Kosto indikative					
		Institucioni drejtues	Institucionet pjesëmarrëse	Data e fillimit	Data e mbarimit	Korente	Kapitale	Total Kosto	Total BSH	Total FH	Hendeku Financiar
						Korente	Kapitale	Total Kosto	Total BSH	Total FH	
3.1	3.1 Objektivi Specifik 3.1 Reformimi i kurikulës së shkencës në arsimin parauniversitar duke përfshirë STEM në edukim.	MAS	AKKSHI, ASCAP, MFE	2023	2030						
3.1.1	3.1.1 Identifikimi i praktikave ndërkombëtare në drejtëm të rishikimit të kurikulave për përfshirjen e STEM në edukim	MAS	AKKSHI, ASCAP	2023	2030	724,420	0	724,420	4,420	0	-720,000
3.1.2	3.1.2 Përgatitja e stafit pedagogjik lidhur me realizimin e praktikave kërkimore dhe zhvillimin e projekteve kërkimore në sistemin parauniversitar	MAS	AKKSHI	2023	2030	6,162,455	0	6,162,455	2,062,457	0	-4,099,998
3.1.3	3.1.3 Promovimi dhe përfshirja e orëve jashtë-kurikulare në arsimin parauniversitar mbi STEM	MAS	AKKSHI MFE	2023	2030	26,397,401	0	26,397,401	25,721,000	0	-676,401
3.1.4	3.1.4 Përmirësimi i laboratorëve për zhvillimin e lëndëve STEM	MAS	MFE ASCAP	2023	2025	0	362,951,472	362,951,472	240,000,000	122,951,472	0
	Kosto Objektivi specifik 3.1					33,284,276	362,951,472	396,235,748	267,787,877	122,951,472	-5,496,399
3.2	3.2 Objektivi specifik 2: Sensibilizimi në të gjitha nivelet e edukimit parauniversitar, për fuqizimin e rolit të rinjve në kërkim dhe inovacion.	MAS, ASCAP	AKKSHI, MFE, Bashkitë, DPPI	2023	2030						
3.2.1	3.2.1 Angazhimi vazhdueshëm për mirinformimin e nxënësve të klasave të 9 dhe nxënësit e gjimnazeve për mundësitë që vijnë nga përfshirja në kërkim dhe inovacion	MAS	AKKSHI, MFE, Bashkitë, DPPI, ASCAP	2023	2030	4,748,808	0	4,748,808	2,475,214	0	-2,273,594
3.2.2	3.2.2 Promovimi dhe përfshirja e orëve/kurseve/aktivitetëve jashtë-kurikulare për inovacionin në sistemin parauniversitar	ASCAP	MAS	2023	2030	16,389,061	0	16,389,061	2,059,060	0	-14,330,001

	Kosto Objektivi specifik 3.2					21,137,869	0	21,137,869	4,534,274	0	-16,603,595
3.3	3.3 Objektivi Specifik 3: Zhvillimi i kompetencës digjitale	ASCAP	MAS	2023	2030						
3.3.1	3.3.1 Përmirësimi i kurikulës, futja e TIK-ut në klasën e pare	ASCAP	MAS	2023	2030	68,090,389	0	68,090,389	64,590,388	0	-3,500,001
3.3.2	3.3.2 Zhvillimi i kompetencave digjitale të mësuesve përmes trajnimeve	ASCAP	MAS	2023	2030	12,905,804	0	12,905,804	3,345,805	0	-9,559,999
3.3.3	3.3.3 Përmirësimi i infrastrukturës, <i>Smart lab</i> -eve dhe pajisjeve të tjera të nevojshme	ASCAP	MAS	2023	2030	1,359,147	757,150,000	758,509,147	545,359,152	213,150,000	0
	Kosto Objektivi specifik 3.3					82,355,340	757,150,000	839,505,340	613,295,345	213,150,000	-13,060,000
	Kosto totale Qëllimi i politikës III (objektiva specifike 3.1+3.2+3.3)					136,777,485	1,120,101,472	1,256,878,957	885,617,496	336,101,472	-35,159,994
	Kostoja totale e planit të veprimit = QP I + QP II + QP III					4,640,765,987	22,920,524,798	27,561,290,785	16,493,103,827	3,233,093,672	-7,835,093,284

Tregues të detajuar për kostimin të detajuar të projektligjit për shkencën , të harmonizuar dhe me tregues të kostimit të Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023-2030, si dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj, jepen në tabelën nr.1, sa vijon:

Tabela nr.1	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028	Viti 2029	Viti 2030	Total Kostim Strategji
PBB në mijë lekë , parashikuar për periudhën 2023-2030	2,176,100,000	2,285,879,000	2,401,850,000	2,473,905,500	2,548,122,665	2,624,566,345	2,703,303,335	2,784,402,435	
Shpenz. publike në mijë lekë, parashikuar për periudhën 2023-2030	687,209,000	697,426,000	730,752,000	752,674,560	775,254,797	798,512,441	822,467,814	847,141,848	

Fondet e parashikuara, "Për shkencën", në mijë lekë në draft strategji për periudhën 2023-2030	1,830,464	2,596,391	2,901,649	3,763,379	3,718,380	3,917,952	4,320,086	4,512,991	27,561,291
Në % ndaj PBB-së	0.084%	0.114%	0.121%	0.152%	0.146%	0.149%	0.160%	0.162%	
Në % ndaj shpenzimeve publike	0.27%	0.37%	0.40%	0.50%	0.48%	0.49%	0.53%	0.53%	

KËSHILLI I MINISTRAVE